

VENDIM
Nr. 99, datë 18.2.2005

PËR MIRATIMIN E KATALOGUT SHQIPTAR TË KLASIFIKIMIT TË MBETJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 3 të ligjit nr.9010, datë 13.2.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve, në përputhje me Katalogun European të Mbetjeve, sipas aneksit A që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe është pjesë përbërëse e tij, e që përmbledh shtojcat I, II, III dhe IV, në të cilat jepen përkatësisht:

a) **Shtojca I: Klasifikimi i mbetjeve;**

b) Shtojca II: **Vetitë dhe karakteristikat e mbetjeve të rrezikshme;**

c) Shtojca III: **Kategoritë e mbetjeve të gjeneruara, të listuara sipas natyrës së tyre (III.A) dhe veprimtarisë që i gjeneron ato (III.B);**

ç) Shtojca IV: Përbërësit e mbetjeve të shtojcës III.B që i bëjnë ato të rrezikshme, kur paraqesin vetitë e përshkruara në shtojcën II.

2. Në kuptim të këtij vendimi vlerësohen si të rrezikshme:

a) mbetjet e shtojcës I, **të shënuara me "*" , të cilat paraqesin një rënë apo më shumë nga vetitë e listuara në shtojcën II ose kanë një apo më shumë substanca të listuara në shtojcën IV;**

b) mbetjet e rrezikshme, të përcaktuara si të tilla nga konventa e Baselit "Për kontrollin e lëvizjeve ndërkontinentale të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre".

3. Katalogu Shqiptar i Klasifikimit të Mbetjeve të rishikohet dhe të plotësohet sipas ndryshimeve përkatëse të Katalogut European të Mbetjeve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

Hyrje

1. **Tipet e ndryshme të mbetjeve në katalog janë të përcaktuara me një kod 6-shifror, ndërsa sektorët ekonomikë dhe nënndarjet përkatëse që i gjenerojnë këto mbetje, jepen përkatësisht me kode 2-shifrorë dhe 4-shifrorë.**

2. Numrat 6-shifrorë të kodeve të mbetjeve, në rastet kur nuk ka pasur ndryshime në klasifikimin e mbetjeve sipas Katalogut përkatës European kanë mbetur po ato. Në rastet kur në amendimet e herëpashërshme klasifikimi ka ndryshuar, kodet e vjetra janë fshirë si të papërdorshme, për të shmangur konfuzionet që mund të vijnë nga ndryshimet në renditje.

3. Tipet e mbetjeve në katalog emërtohen si më poshtë:

01. mbetje që dalin nga kërkimet dhe shfrytëzimi i minierave dhe karrierave, si edhe nga trajtimet fiziko-kimike të mineraleve;

02. mbetje që dalin nga bujqësia (agrikultura), kopshtaria (hortikultura) ujërat, pylltaria

- (silvikultura), gjuetia dhe peshkimi, si edhe përgatitja dhe përpunimet e ushqimeve;
03. mbetje që dalin nga përpunimi i drurit dhe prodhimi i paneleve dhe mobilieve, brumit të letrës, letrës dhe kartonit;
04. mbetje që dalin nga industria e lëkurëve, peliçeritë dhe tekstili;
05. mbetje të dala nga rafinimi i naftës nga pastrimi i gazit natyror dhe nga trajtime pirolotike të karbonit;
06. mbetje të kimisë minerale;
07. mbetje nga proceset e kimisë organike;
- 08 mbetje nga fabrikimi, formulimi, shpërndarja dhe përdorimi i lëndëve të veshjes (bojëra, llaqe dhe emalime të tejudkshme), ngjitëse, stukove dhe bojëra stampimi;
09. mbetje të industrisë fotografike;
10. mbetje nga proceset termike;
11. mbetje nga trajtimi kimik i sipërfaqeve dhe veshjeve të metaleve dhe materialeve të tjerë; hidrometalurgjia e metaleve joferrorë;
12. mbetje nga trajtimi fiziko-mekanik dhe dhënia e formës së metaleve dhe plastikave;
13. mbetje vajrash dhe mbetje të karburanteve të lëngshëm (përveç vajrave ushqimore dhe ato në kapitullin 05 12 19);
14. tretës të mbetjeve organike ftohës dhe pompues (përveç 07 dhe 08) ;
15. paketime mbeturinash; absorbente, rroba fshirëse, materiale të filtrave dhe rroba mbrojtëse të paspecifikuara ndryshe;
16. mbetje të paspecifikuara në listë;
17. mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (përfshi dhëra të gërmuara nga zona të kontaminuara);
18. mbetje nga kujdesi shëndetësor njerëzor ose shtazor dhe kërkime që lidhen me to (me përjashtim të mbetjeve të kuzhinave dhe restoranteve që nuk lidhen drejtpërdrejt me kujdesin shëndetësor);
19. mbetje nga impiantet e trajtimit të mbetjeve, të ujërave të ndotur (jo në vend) dhe përgatitja e ujit për përdorim njerëzor dhe industrial;
20. mbetjet urbane (mbetjet shtëpiake dhe tregtare, mbetje industriale e institucionale të ngjashme) përfshirë fraksionet e mbledhura veçmas.

- 01 MBETJE QË DALIN NGA KËRKIMET E SHFRYTËZIMI I MINIERAVE DHE KARRIERAVE, SI EDHE NGA TRAJTIMET FIZIKO - KIMIKE TË MINERALEVE
- 01 01 Mbetje që dalin nga nxjerrja e mineraleve
- 01 01 01 Mbetje që dalin nga nxjerrja e mineraleve metalore
- 01 01 02 Mbetje që dalin nga nxjerrja e mineraleve jometalore
- 01 03 Mbetje që dalin nga përpunimi fiziko-kimik i mineraleve metalore
- 01 03 04 * Sterile acide që vijnë nga përpunimi i xeherorëve me përmbajtje të squfurit
- 01 03 05 * Sterile të tjera që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 01 03 06 Sterile të tjera nga ato të përmendura në 01 03 04 dhe 01 03 05
- 01 03 07 * Mbetje të tjera që përmbajnë substanca të rrezikshme që dalin nga përpunimet fiziko-kimike të mineraleve metalore
- 01 03 08 Mbetje pluhurash, përveç atyre të përmendura në rubrikën 01 03 07
- 01 03 09 Mbetje (në formë balte të kuqe) e dalë nga prodhimi i aluminit, të tjera nga ato të përmendura në 01 03 07
- 01 03 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 01 04 Mbetje që dalin nga përpunimet fiziko-kimike të mineraleve jometalore
- 01 04 07 * Mbetje që përmbajnë substanca të rrezikshme që vijnë nga përpunimet fiziko-kimike të mineraleve jometalore

- 01 04 08 Mbetje zhavorri dhe mbetje gurësh të tjera nga ato të përmendura në 01 03 07
- 01 04 09 Mbetje rërash dhe argjilash
- 01 04 10 Mbetje pluhurash, të tjera nga ato të përmendura në 01 04 07
- 01 04 11 Mbetje nga përpunimi i kripërave të potasit, të tjera nga ato të përmendura në 01 04 07
- 01 04 12 Sterile dhe mbetje të tjera që vijnë nga larja dhe pastrimi i mineraleve, të tjera nga ato të përmendura në 01 04 07 dhe 01 04 11
- 01 04 13 Mbetje që vijnë nga prerja dhe sharrimi i gurëve, të tjera nga ato të përmendura në 01 04 07
- 01 04 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 01 05 Balta nga shpimet dhe mbetje të tjera nga shpimet
- 01 05 04 Balta dhe mbetje të tjera nga shpimet për ujë të ëmbël
- 01 05 05 * Baltë dhe mbetje të tjera nga shpimet për naftë hidrokarbure
- 01 05 06 * Baltë dhe mbetje të tjera nga shpimet që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 01 05 07 Baltë dhe mbetje të tjera nga shpimet të cilat përmbajnë kripëra të bariumit, të tjera nga ato të përmendura në 01 05 05 dhe 01 05 06
- 01 05 08 Baltë dhe mbetje të tjera nga shpimet të cilat përmbajnë klorure, të tjera nga ato të përmendura në 01 05 06
- 01 05 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 02 **MBETJE QË DALIN NGA BUJQËSIA (AGRIKULTURA), KOPSHTARIA (HORTIKULTURA), UJËRAT, PYLLTARIA (SILVIKULTURA), GJUETIA DHE PESHKIMI, SI EDHE PËRGATITJA DHE PËRPUNIMET E USHQIMEVE**
- 02 01 Mbetjet që vijnë nga bujqësia, nga kopshtaria, nga gjuetia dhe peshkimi
- 02 01 01 Llumra që vijnë nga larja dhe pastrimi
- 02 01 02 Mbetje nga indet e kafshëve
- 02 01 03 Mbetje të indeve bimore
- 02 01 04 Mbetje të lëndëve plastike (me përjashtim të ambalazheve)
- 02 01 06 Fekale, urinë dhe pleh (duke futur këtu dhe pleh kashtë të prishur), rrjedhje, mbeturina të ndara dhe të trajtuara jashtë qendrës së trajtimit
- 02 01 07 Mbetje që vijnë nga pylltaria (silvikultura)
- 02 01 08 * Mbetje bujqësore që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 02 01 09 Mbetje bujqësore, përveç atyre të paraqitura në rubrikën 02 01 08
- 02 01 10 Mbetje metalike
- 02 01 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 02 02 Mbetje që vijnë nga përgatitja dhe përpunimi i mishit, peshkut dhe ushqimeve të tjera me origjinë shtazore
- 02 02 01 Llumra që vijnë nga larja dhe pastrimi
- 02 02 02 Mbetje që vijnë nga indet shtazore
- 02 02 03 Materiale të papërshtatshme për konsum apo për përpunim
- 02 02 04 Llumra që vijnë nga trajtimi në vend i rrjedhjeve
- 02 02 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 02 03 Mbetje që vijnë nga përgatitja dhe përpunimi i frutave, perimeve, drithërave, vajrave ushqimore, i kakaos, kafesë, çajit, duhanit, të prodhimit të konservave, të prodhimit të majasë dhe të ekstrakteve të majasë, të përgatitjes dhe të fermentimit të melasës
- 02 03 01 Llumra që vijnë nga larja, nga pastrimi, nga qërimi, nga centrifugimi dhe nga ndarja
- 02 03 02 Mbetje të agjentëve të konservimit
- 02 03 03 Mbetje nga ekstraktimi me solvent

02 03 04	Lëndë të papërshtatshme për konsum apo përpunim
02 03 05	Llumra që vijnë nga trajtimi në vend i rrjedhjeve
02 03 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
02 04	Mbetje nga përpunimi i sheqerit
02 04 01	Dhera me prejardhje nga larja dhe pastrimi i panxharit të sheqerit
02 04 02	Karbonat kalciumi i precipituar
02 04 03	Baltra që vijnë nga trajtimi në qendër i rrjedhjeve
02 04 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
02 05	Mbetje që vijnë nga industria e prodhimit të qumështit
02 05 01	Lëndë të papërshtatshme për konsum apo përpunim
02 05 02	Llumra që vijnë nga trajtimi në vend i rrjedhjeve
02 05 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
02 06	Mbetje të industrisë së bukës, ëmbëlsirave
02 06 01	Lëndë të papërshtatshme për konsum apo përpunim
02 06 02	Mbetje të agjentëve të konservimit
02 06 03	Llumra që vijnë nga trajtimi në vend i rrjedhjeve
02 06 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
02 07	Mbetje që vijnë nga prodhimi i pijeve alkoolike dhe joalkoolike (përveç kafesë, çajit, dhe kakaos)
02 07 01	Mbetje që vijnë nga larja, pastrimi dhe përpunimi mekanik i lëndëve të para
02 07 02	Mbetje nga distilimi i alkoolit
02 07 03	Mbetje nga trajtimet kimike
02 07 04	Lëndë të papërshtatshme për konsum apo përpunim
02 07 05	Llumra që vijnë nga trajtimi në vend i rrjedhjeve
02 07 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
03	MBETJE QË DALIN NGA PËRPUNIMI I DRURIT DHE PRODHIMI I PANELEVE DHE MOBILJEVE, BRUMIT TË LETRËS, LETRËS DHE KARTONIT
03 01	Mbetje që dalin nga përpunimi i drurit dhe prodhimi i paneleve dhe mobilieve
03 01 01	Mbetje të lëvores dhe të tapës
03 01 04*	Pluhur sharrë, ashklat, copa prej druri, panele me materiale grimcore dhe me pllaka që përmbajnë materiale të rrezikshme
03 01 05	Pluhur sharre, ashklat, copa prej druri, panele me materiale grimcore dhe me pllaka, të tjera nga ato të përmendura në 03 01 04
03 01 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
03 02	Mbetje të produkteve që përdoren në staxhionimin e drurëve
03 02 01*	Komponime organike jo të halogjenuara që përdoren për staxhionimin e drurëve
03 02 02*	Komponime organike të kloruara që përdoren për staxhionimin e drurëve
03 02 03*	Komponime organometalike që përdoren për staxhionimin e drurëve
03 02 05*	Komponime inorganike që përdoren për staxhionimin e drurëve
03 02 05*	Komponime të tjera që përdoren për staxhionimin e drurëve që përmbajnë substanca të rrezikshme
03 02 99	Staxhionues të tjerë të paspecifikuar
03 03	Mbetje që dalin nga prodhimi dhe përpunimi i letrës, kartonit dhe brumit të letrës
03 03 01	Mbetje të lëvoreve dhe drurit
03 03 02	Llumra të lëngshme të gjelbra (që vijnë nga rikuperimi i lëngjeve të zierjes)
03 03 05	Llumra të çngjyrosura që dalin nga riciklimi i letrës

03 03 07	Mbetje skarco të ndara mekanikisht që vijnë nga pulpëzimi i mbetjeve të letrës dhe kartonit
03 03 08	Mbetje që dalin nga seleksionimi i letrave dhe kartonëve të destinuara për riciklim
03 03 09	Baltë që del nga trajtimi me gëlqere
03 03 10	Mbetje skarco fibroze, llumra të mbushjeve dhe të veshjeve të dala nga ndarjet mekanike
03 03 11	Mbetje të dala nga trajtimi në vend i rrjedhjeve, të tjera nga ato të përmendura në 03 03 10
03 03 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
04	MBETJE QË DALIN NGA INDUSTRIA E LËKURËVE, PELIÇERITË DHE TEKSTILI
04 01	Mbetje që dalin nga industria e lëkurëve dhe peliçeve
04 01 01	Mbetje nga rrjepjet dhe prerjet
04 01 02	Mbetje gëlqerore
04 01 03*	Mbetjet nga heqja e yndyrave që përmbajnë tretës pa fazë të lëngët
04 01 04	Lëngje nga regjia e lëkurëve që përmbajnë kromi
04 01 05	Lëngje nga regjia e lëkurëve që nuk përmbajnë krom
04 01 06	Llumra që vijnë kryesisht nga trajtimi në vend i rrjedhjeve që përmbajnë krom
04 01 07	Llumra që vijnë kryesisht nga trajtimi në vend i rrjedhjeve që nuk përmbajnë krom
04 01 08	Mbetje të lëkurës së regjur (preje, kanale, mostrime, pluhura nga përpunimi) që përmbajnë krom
04 01 09	Mbetje që vijnë nga veshjet dhe lustrimet
04 01 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
04 02	Mbetje të industrisë së tekstilit
04 02 09	Materiale të përziera (tekstile të imprenjuara, elastomere, plastomere)
04 02 10	Lëndë organike të dala nga produkte natyrore (p.sh. dhjamra, dyllra)
04 02 14*	Mbetje që dalin nga përpunimet e fundit me tretës organike
04 02 15	Mbetje që dalin nga përpunimet e tjera, përveç ato të përmendura në 04 02 14
04 02 16*	Ngjyrosës dhe pigmente që përmbajnë substancë të rrezikshme
04 02 17	Ngjyrosës dhe pigmente, përveç atyre të përmendura në 04 02 16
04 02 19*	Mbetje të dala nga trajtimet në vend të rrjedhjeve që përmbajnë substanca të rrezikshme
04 02 20	Mbetje të dala nga trajtimet në vend, përveç atyre të përmendura në 04 02 19
04 02 21	Mbetje të fibrave tekstile të papërpunuara
04 02 22	Mbetje të fibrave tekstile të përpunuara
04 02 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
05	MBETJE TË DALA NGA RAFINIMI I NAFTËS NGA PASTRIMI I GAZIT NATYROR DHE NGA TRAJTIME PIROLOTIKE TË KARBONIT
05 01	Mbetje që vijnë nga rafinimi i naftës
05 01 02*	Llumra të shkripëzimit
05 01 03*	Llumra të fundit të depozitave
05 01 04*	Llumra të alkileve acide
05 01 05*	Derdhje naftë të shpërndarë aksidentalisht
05 01 06*	Llumra të naftës që dalin nga operacionet e mirëmbajtjes së impiantit apo pajisjeve
05 01 07*	Mbetje zifti acide
05 01 08*	Mbetje zifti të tjera dhe bitume

05 01 09*	Llumra që vijnë nga trajtimi në vend i rrjedhjeve që përmbajnë substanca të rrezikshme
05 01 10	Llumra që vijnë nga trajtimi në vend i rrjedhjeve të tjera nga ato të përmendura në 05 01 09
05 01 11*	Mbetjet që vijnë nga pastrimi i lëndëve djegëse me baza (alkale)
05 01 12*	Nafta që përmbajnë acide
05 01 13	Llumra të dala nga trajtimi i ujit ushqyes të kaldajave
05 01 14	Mbetjet që vijnë nga kolonat e ftohjes
05 01 15*	Argjila që dalin nga filtrimet

1 Në rastet e përmbajtjes së Cr-6, këto mbetje konsiderohen të rrezikshme

2 Në rastet e përmbajtjes së Cr-6, këto mbetje konsiderohen të rrezikshme

05 01 16	Mbetjet që përmbajnë squfur të dala nga procesi i desulfurimit të naftës
05 01 17	Përzierje bituminoze
05 01 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
05 06	Mbetjet e dala nga trajtimi pirolitik i qymyreve
05 06 01*	Zifte acid
05 06 03*	Zifte të tjera
05 06 04	Mbetje të dala nga kolonat e ftohjes
05 06 99	Mbeturina të tjera të paspecifikuara
05 07	Mbetje të dala nga pastrimi dhe transporti i gazit natyror
05 07 01*	Mbetje që përmbajnë merkur (Hg)
05 07 02	Mbetje që përmbajnë squfur
05 07 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
06	MBETJE TË KIMISË MINERALE
06 01	Mbetje që dalin nga fabrikimi, formulimi, shpërndarja dhe përdorimi (FFSHP) i acideve
06 01 01*	Acid sulfurik dhe acid sulfuror
06 01 02*	Acid klorhidrik
06 01 03*	Acid fluorhidrik
06 01 04*	Acid fosforik dhe acid fosforor
06 01 05*	Acid nitrik dhe acid nitror
06 01 06*	Acide të tjera
06 01 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
06 02	Mbetje që dalin nga FFSHP i bazave
06 02 01*	Hidroksidi i kalciumit
06 02 03*	Hidroksidi i amonit
06 02 04*	Hidroksidi i natriumit dhe kaliumit
06 02 05*	Baza të tjera
06 02 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
06 03	Mbetje që dalin nga FFSHP i kripërave dhe tretësirave të tyre dhe i oksideve metalike
06 03 11*	Kripëra të ngurta dhe tretësira që përmbajnë cianure
06 03 13*	Kripëra të ngurta dhe tretësira që përmbajnë metale të rënda
06 03 14	Kripëra të ngurta dhe tretësira të tjera, përveç atyre të përmendura në 06 03 11 dhe 06 03 13
06 03 15*	Okside metalike që përmbajnë metale të rënda

06 03 16	Okside metalike të tjera, përveç atyre të përmendura në 06 03 15
06 03 99	Mbeturina të tjera të paspecifikuara
06 04	Mbetje që përmbajnë metale, përveç atyre të përmendura në rubrikën 06 03
06 04 03*	Mbetje që përmbajnë arsenik
06 04 04*	Mbetje që përmbajnë merkur
06 04 05	Mbetje që përmbajnë metale të tjera të rënda
06 04 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
06 05	Llumra që dalin nga trajtimet në vend të rrjedhjeve
06 05 02*	Llumra që vijnë nga trajtimi në vend i rrjedhjeve që përmbajnë substanca të rrezikshme
06 05 03	Llumra që vijnë nga trajtimi në vend i rrjedhjeve të tjera përveç atyre të përmendura në rubrikën 06 05 02
06 06	Mbetje që vijnë nga FFSHP i kimikateve të squfurit, të proceseve të kimisë së squfurit dhe të proceseve të desulfurimit
06 06 02*	Mbetje që përmbajnë sulfidë të rrezikshëm
06 06 03	Mbetje që përmbajnë sulfidë të tjera nga ato të përmendura në 06 06 02
06 07 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
06 07	Mbetje që vijnë nga FFSHP i halogjenëve dhe nga kimia e halogjenëve
06 07 01*	Mbetje që përmbajnë asbest që vjen nga elektroliza
06 07 02*	Karbon i aktivizuar nga prodhimi i klorit
06 07 03*	Llumra të sulfatit të bariumit që përmbajnë merkur
06 07 04*	Solucione dhe acide, p.sh. acide kontakti
06 07 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
06 08	Mbetje që vijnë nga FFSHP i silicit dhe derivateve të silicit
06 08 02	Mbetje që përmbajnë silikone të rrezikshme
06 08 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
06 09	Mbetje që vijnë nga FFSHP i kimikateve të fosforit dhe të proceseve të kimisë së fosforit
06 09 02	Llumra fosforike
06 09 03*	Mbetje të reaksioneve me bazë kalciumin që përmbajnë ose janë të kontaminuara me substanca të rrezikshme
06 09 04	Mbetje të reaksioneve me bazë kalciumi, të tjera nga ato të përmendura në 06 09 03
06 09 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
06 10	Mbetje që vijnë nga FFSHP i kimikateve të azotit, nga proceset kimike të azotit dhe nga prodhimi i plehrave azotike
06 10 02*	Mbetje që përmbajnë substanca të rrezikshme
06 10 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
06 11	Mbetje që dalin nga prodhimi i pigmenteve dhe turbullirave inorganike
06 11 01	Mbetje të reaksioneve me bazë kalciumi, që dalin nga prodhimi i dyoksidit të titanit
06 11 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
06 13	Mbetje që dalin nga proceset kimike inorganike të paspecifikuara
06 13 01*	Produkte inorganike, të mbrojtjes së bimëve, konservues të drurit dhe biocide të tjera
06 13 02*	Karbon aktiv i përdorur (përfshirë 060702)
06 13 03	Karbon i zi
06 13 04*	Mbetje që vijnë nga transformimi i asbestit
06 13 05*	Bloza
06 13 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara

- 07 MBETJE NGA PROCESET E KIMISË ORGANIKE
- 07 01 Mbetje që dalin nga fabrikimi, formulimi, shpërndarja dhe përdorimi (FFSHP) i kimikateve organike bazë
- 07 01 01* Lëngje ujore të larjes dhe lëngje meme ujore
- 07 01 03* Tretës, lëngje larës dhe lëngje meme organike të halogjenuar
- 07 01 04* Tretës, lëngje larës dhe lëngje meme organike të tjerë
- 07 01 07* Mbetje të halogjenuara të distilimit dhe mbetje të halogjenuara të reaksioneve
- 07 01 08* Mbetje të tjera të distilimit dhe mbetje të tjera të reaksioneve
- 07 01 09* Shtresa filtri dhe absorbentë të përdorur të halogjenuar
- 07 01 10* Shtresa filtri dhe absorbentë të përdorur të tjerë
- 07 01 11* Llumra nga trajtimi në vend i rrjedhjeve (derdhjeve) që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 07 01 12 Llumra nga trajtimi në vend i rrjedhjeve të tjera nga ato të përmendura në 07 01 11
- 07 01 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 07 02 Mbetje nga fabrikimi, formulimi, shpërndarja dhe përdorimi (FFSHP) i plastikëve, gomave sintetike dhe fibrave të bëra nga njeriu
- 07 02 01* Lëngje ujore të larjes dhe lëngje mëmë ujore
- 07 02 03* Tretës, lëngje larës dhe lëngje mëmë organike të halogjenuar
- 07 02 04* Tretës, lëngje larës dhe lëngje mëmë organike të tjerë
- 07 02 07* Mbetje të halogjenuara të distilimit dhe mbetje të halogjenuara të reaksioneve
- 07 02 08* Mbetje të tjera të distilimit dhe mbetje të tjera të reaksioneve
- 07 02 09* Shtresa filtri dhe absorbentë të përdorur të halogjenuar
- 07 02 10* Shtresa filtri dhe absorbentë të përdorur të tjerë
- 07 02 11* Llumra nga trajtimi në vend i rrjedhjeve (derdhjeve) që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 07 02 12 Llumra nga trajtimi në vend i rrjedhjeve të tjera nga ato të përmendura në 07 02 11
- 07 02 13 Mbetje plastike
- 07 02 14* Mbetje nga materialet shtesë që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 07 02 15 Mbetje nga materialet shtesë të tjera nga ato të përmendura në 07 02 14
- 07 02 16* Mbetje që përmbajnë silikonë të rrezikshëm
- 07 02 17 Mbetje që përmbajnë silikonë të tjerë nga ato të përmendura në 07 02 16
- 07 02 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 07 03 Mbetje nga fabrikimi, formulimi, shpërndarja dhe përdorimi (FFSHP) i ngjyruësve organikë dhe pigmenteve (përveç 06 11)
- 07 03 01* Lëngje ujore të larjes dhe lëngje mëmë ujore
- 07 03 03* Tretës, lëngje larëse dhe lëngje mëmë organike të halogjenuar
- 07 03 04* Tretës, lëngje larëse dhe lëngje mëmë organike të tjerë
- 07 03 07* Mbetje të halogjenuara të distilimit dhe mbetje të halogjenuara të reaksioneve
- 07 03 08* Mbetje të tjera të distilimit dhe mbetje të tjera të reaksioneve
- 07 03 09* Shtresa filtri dhe absorbente të përdorur të halogjenuar
- 07 03 10* Shtresa filtri dhe absorbente të përdorur të tjerë
- 07 03 11* Llumra nga trajtimi në vend i rrjedhjeve (derdhjeve) që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 07 03 12 Llumra nga trajtimi në vend i rrjedhjeve të tjera nga ato të përmendura në 07 03 11
- 07 03 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 07 04 Mbetje nga fabrikimi, formulimi, shpërndarja dhe përdorimi (FFSHP) i produkteve organike të mbrojtjes së bimëve (përveç 02 01 08 dhe 02 01 09),

- agjentëve të ruajtjes (konservimit) së drurit (përveç 03 02) dhe biocideve të tjera
- 07 04 01* Lëngje ujore të larjes dhe lëngje mëmë ujore
- 07 04 03* Tretës, lëngje larëse dhe lëngje mëmë organike të halogjenuar
- 07 04 04* Tretës, lëngje larëse dhe lëngje mëmë organike të tjerë
- 07 04 07* Mbetje të halogjenuara të distilimit dhe mbetje të halogjenuara të reaksioneve
- 07 04 08* Mbetje të tjera të distilimit dhe mbetje të tjera të reaksioneve
- 07 04 09* Shtresa filtri dhe absorbente të përdorur të halogjenuar
- 07 04 10* Shtresa filtri dhe absorbente të përdorur të tjerë
- 07 04 11* Llumra nga trajtimi në vend i rrjedhjeve (derdhjeve) që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 07 04 12 Llumra nga trajtimi në vend i rrjedhjeve të tjera nga ato të përmendura në 07 04 11
- 07 04 13* Mbetje të ngurta që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 07 04 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 07 05 Mbetje nga fabrikimi, formulimi, shpërndarja dhe përdorimi (FFSHP) i lëndëve farmaceutike
- 07 05 01* Lëngje ujore të larjes dhe lëngje mëmë ujore
- 07 05 03* Tretës, lëngje larëse dhe lëngje mëmë organike të halogjenuar
- 07 04 04* Tretës, lëngje larëse dhe lëngje mëmë organike të tjerë
- 07 05 04* Tretës, lëngje larëse dhe lëngje mëmë organike të tjerë
- 07 05 07* Mbetje të halogjenuara të distilimit dhe mbetje të halogjenuara të reaksioneve
- 07 05 08* Mbetje të tjera të distilimit dhe mbetje të tjera të reaksioneve
- 07 05 09* Shtresa filtri dhe absorbente të përdorur të halogjenuar
- 07 05 10* Shtresa filtri dhe absorbente të përdorur të tjerë
- 07 05 11* Llumra nga trajtimi në vend i rrjedhjeve (derdhjeve) që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 07 05 12 Llumra nga trajtimi në vend i rrjedhjeve të tjera nga ato të përmendura në 07 05 11
- 07 05 13* Mbetje të ngurta që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 07 05 14 Mbetje të ngurta të tjera nga ato të përmendura në 07 05 13
- 07 05 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 07 06 Mbetje nga fabrikimi, formulimi, shpërndarja dhe përdorimi (FFSHP) i lëndëve yndyrore, grasos, sapunëve, detergjenteve, disifektantëve dhe të kozmetikës
- 07 06 01* Lëngje ujore të larjes dhe lëngje mëmë ujore
- 07 06 03* Tretës, lëngje larëse dhe lëngje mëmë organike të halogjenuar
- 07 06 04* Tretës, lëngje larëse dhe lëngje mëmë organike të tjera
- 07 06 07* Mbetje të halogjenuara të distilimit dhe mbetje të halogjenuara të reaksioneve
- 07 06 08* Mbetje të tjera të distilimit dhe mbetje të tjera të reaksioneve
- 07 06 09* Shtresa filtri dhe absorbente të përdorur të halogjenuar
- 07 06 10* Shtresa filtri dhe absorbente të përdorur të tjerë
- 07 06 11* Llumra nga trajtimi në vend i rrjedhjeve (derdhjeve) që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 07 06 12 Llumra nga trajtimi në vend i rrjedhjeve të tjera nga ato të përmendura në 07 06 11
- 07 06 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 07 07 Mbetje nga fabrikimi, formulimi, shpërndarja dhe përdorimi (FFSHP) i kimikateve të pastra dhe produkteve kimike jo të specifikuara diku tjetër
- 07 07 01* Lëngje ujore të larjes dhe lëngje mëmë ujore

- 07 07 03* Tretës, lëngje larëse dhe lëngje mëmë organike të halogjenuar
- 07 07 04* Tretës, lëngje larëse dhe lëngje mëmë organike të tjerë
- 07 07 07* Mbetje të halogjenuara të distilimit dhe mbetje të halogjenuara të reaksioneve
- 07 07 08* Mbetje të tjera të distilimit dhe mbetje të tjera të reaksioneve
- 07 07 09* Shtresa filtri dhe absorbente të përdorur të halogjenuar
- 07 07 10* Shtresa filtri dhe absorbente të përdorur të tjerë
- 07 07 11* Llumra nga trajtimi në vend i rrjedhjeve (derdhjeve) që përmbajnë substance të rrezikshme
- 07 07 12 Llumra nga trajtimi në vend i rrjedhjeve të tjera nga ato të përmendura në 07 07 11
- 07 07 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 08 MBETJE NGA FABRIKIMI, FORMULIMI, SHPËRNDARJA DHE PËRDORIMI (FFSHP) I LËNDËVE TË VESHJES (BOJËRA, LLAQE DHE EMALIME TË TEJDUKSHME), NGJITËS STUKOVE DHE BOJRA STAMPIMI
- 08 01 Mbetje nga fabrikimi, formulimi, shpërndarja dhe përdorimi (FFSHP) dhe heqja e bojërave dhe llaqeve
- 08 01 11* Mbetje të bojërave dhe llaqeve që përmbajnë tretës organikë ose substanca të tjera të rrezikshme
- 08 01 12 Mbetje të bojërave dhe llaqeve, të tjera nga ato të përmendura në 08 01 11
- 08 01 13* Llumra nga bojërat dhe llaqet që përmbajnë tretës organikë ose substanca të tjera të rrezikshme
- 08 01 14 Llumra nga bojërat dhe llaqet, të tjera nga ato të përmendura në 08 01 13
- 08 01 15* Llumra ujorë të bojërave dhe llaqeve që përmbajnë tretës organikë ose substanca të tjera të rrezikshme
- 08 01 16 Llumra ujore të bojërave dhe llaqeve të tjera nga ato të përmendura në 08 01 15
- 08 01 17* Mbetje nga heqja e bojërave dhe llaqeve që përmbajnë tretës organikë ose substanca të tjera të rrezikshme
- 08 01 18 Mbetje nga heqja e bojërave dhe llaqeve të tjera nga ato të përmendura në 08 01 17
- 08 01 19* Suspensione ujore të bojërave dhe llaqeve që përmbajnë tretës organikë ose substanca të tjera të rrezikshme
- 08 01 20 Suspensione ujore të bojërave dhe llaqeve, të tjera nga ato të përmendura në 08 01 19
- 08 01 21* Mbetje të pastrimit të bojërave dhe llaqeve
- 08 01 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 08 02 Mbetje nga fabrikimi, formulimi, shpërndarja dhe përdorimi (FFSHP) të veshjeve të tjera (përfshirë materialet qeramike)
- 08 02 01 Mbetje të pudrave veshëse
- 08 02 02 Llumra ujore që përmbajnë materiale qeramike
- 08 02 03 Suspensione ujore që përmbajnë materiale qeramike
- 08 02 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 08 03 Mbetje nga fabrikimi, formulimi, shpërndarja dhe përdorimi (FFSHP) i bojërave të printimit
- 08 03 07 Llumra ujore që përmbajnë bojëra
- 08 03 08 Mbetje të lëngjeve ujore që përmbajnë bojëra
- 08 03 12* Mbetje të bojërave që përmbajnë substancë të rrezikshme
- 08 03 13 Mbetje të bojërave të tjera nga ato të përmendura në 08 03 12
- 08 03 14* Llumra të bojërave që përmbajnë substancë të rrezikshme

- 08 03 15 Llumra të bojërave të tjera nga ato të përmendura në 08 03 14
- 08 03 16* Mbetje të solucioneve gërryes
- 08 03 17* Mbetje nga bojë printi që përmbajnë substancë të rrezikshme
- 08 03 18 Mbetje nga bojë printi, të tjera nga ato të përmendura në 08 03 17
- 08 03 19* Vajra dispërse
- 08 03 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 08 04 Mbetje nga fabrikimi, formulimi, shpërndarja dhe përdorimi (FFSHP) i ngjitësve dhe stukove (përfshi produktet e mbrojtjes nga uji)
- 08 04 09* Mbetje të ngjitësve dhe stukove që përmbajnë tretës organikë ose substanca të tjera të rrezikshme
- 08 04 10 Mbetje të ngjitësve dhe stukove të tjera nga ato të përmendura në 08 04 09
- 08 04 11* Llumra të ngjitësve dhe stukove që përmbajnë tretës organikë ose substanca të tjera të rrezikshme
- 08 04 12 Llumra të ngjitësve dhe stukove të tjera nga ato të përmendura në 08 04 11
- 08 04 13* Llumra ujore të ngjitësve dhe stukove që përmbajnë tretës organikë ose substanca të tjera të rrezikshme
- 08 04 14 Llumra ujore të ngjitësve dhe stukove të tjera nga ato të përmendura në 08 04 13
- 08 04 15* Lëngje ujore të ngjitësve dhe stukove që përmbajnë tretës organikë ose substanca të tjera të rrezikshme
- 08 04 16 Lëngje ujore të ngjitësve dhe stukove të tjera nga ato të përmendura në 08 04 15
- 08 04 17* Vajra rezinë
- 08 04 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 08 05 Mbetje të tjera të paspecifikuara në 08
- 08 05 01* Mbetje të izocianiteve
- 09 MBETJE TË INDUSTRIJË FOTOGRAFIKE
- 09 01 Mbetje nga industria fotografike
- 09 01 01* Tretësira zhvillimi me bazë ujore dhe tretësira aktivizuese
- 09 01 02* Tretësira zhvillimi me bazë ujore të pllakave të kundërpeshës (zhvendosjes)
- 09 01 03* Tretësira zhvillimi me bazë tretësish
- 09 01 04* Tretësira fiksuese
- 09 01 05* Tretësira zbardhuese dhe tretësira zbardhuese fiksuese
- 09 01 06* Mbetje që përmbajnë argjend nga trajtimi në vend i mbetjeve fotografike
- 09 01 07 Filma dhe letër fotografike që përmban argjend apo komponime të argjendit
- 09 01 08 Filma dhe letër fotografike që nuk përmban argjend apo komponime të argjendit
- 09 01 10 Aparat fotografik me njëpërdorim pa bateri
- 09 01 11* Aparat fotografik me njëpërdorim që ka bateri të përfshira në 16 06 01, 16 06 02 ose 16 06 03
- 09 01 12 Aparat fotografik me një-përdorim që ka bateri të tjera nga ato të përmendura në 09 01 11
- 09 01 13* Mbetje të lëngshme ujore të dala nga tharja në vend e argjendit, të tjera nga ato të përmendura në 09 01 06
- 09 01 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 10 MBETJE NGA PROCESET TERMIKE
- 10 01 Mbetje nga stacionet elektrike dhe impiantet e djegies së brendshme (përveç 19)
- 10 01 01 Hi nga fundi, skorje dhe pluhur kaldajash (përjashtuar pluhurin e kaldajave të përmendur në 1001 04)

10 01 02	Hi fluturues
10 01 03	Hi fluturues nga torfat dhe druri i patrajtuar
10 01 04*	Hi fluturues nafte dhe pluhur kaldajash
10 01 05	Mbetje të reaksioneve me bazë kalciumi nga desulfurimi i gazit të oxhakëve në gjendje të ngurtë
10 01 07	Mbetje të reaksioneve me bazë kalciumi nga desulfurimi i gazit të oxhakëve në gjendje llumi
10 01 09*	Acid sulfuric
10 01 13*	Hi fluturues nga emulsionet e hidrokarbureve të përdorura si lëndë djegëse
10 01 14*	Hi nga fundi, skorje dhe pluhur kaldajash që përmbajnë substanca të rrezikshme si rezultat i bashkëdjegies
10 01 15	Hi nga fundi, skorje dhe pluhur kaldajash si rezultat i bashkëdjegies, të tjera nga ato të përmendura në 10 01 14
10 01 16*	Hi fluturues nga co-icenerimi, që përmbajnë substanca të rrezikshme
10 01 17	Hi fluturues nga co-icenerimi, të tjera nga ato të përmendura në 10 01 16
10 01 18*	Mbetje nga pastrimi i gazit që përmban substanca të rrezikshme
10 01 19	Mbetje nga pastrimi i gazit, të tjera nga ato të përmendura në 10 01 05, 10 01 07 dhe 10 01 18
10 01 20*	Llumra nga trajtimi në vend i derdhjeve që përmbajnë substanca të rrezikshme
10 01 21	Llumra nga trajtimi në vend i derdhjeve, të tjera nga ato të përmendura në 10 01 20
10 01 22*	Llumra ujore nga pastrimi i kaldajave që përmban substanca të rrezikshme
10 01 23	Llumra ujore nga pastrimi i kaldajave, të tjera nga ato të përmendura në 10 01 22
10 01 24	Rërë nga shtresat vluese
10 01 25	Mbetje nga magazinimi i lëndëve djegëse dhe TEC me qymyr
10 01 26	Mbetje nga trajtimet e ujërave ftohës
10 01 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
10 02	Mbetje nga industria e hekurit dhe e çelikut
10 02 01	Mbetje nga përpunimi i skorieve
10 02 02	Skorie e papërpunuar
10 02 07*	Mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme
10 02 08	Mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve, të tjera nga ato të përmendura në 10 02 07
10 02 10	Smerc nga mulliri
10 02 11*	Mbetje nga trajtimet e ujërave ftohës që përmbajnë naftë
10 02 12	Mbetje nga trajtimet e ujërave ftohës, të tjera nga ato të përmendura në 10 02 11
10 02 13*	Llumra dhe shtresa filtri nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme
10 02 14	Llumra dhe shtresa filtri nga trajtimet e gazeve, të tjera nga ato të përmendura në 10 02 13
10 02 15	Llumra dhe shtresa filtri të tjera
10 02 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
10 03	Mbetje nga metalurgjia termike e aluminit
10 03 02	Skrape anodike
10 03 04*	Skrape të prodhimit primar
10 03 05	Mbetje të aluminit
10 03 08*	Zgjyra kripore nga prodhimi dytësor
10 03 09*	Zgjyra të zeza nga prodhimi dytësor

- 10 03 15* Shkuma që janë të djegshme ose emetojnë në rast kontakti me ujin gaze të djegshme në sasi të rrezikshme
- 10 03 16 Shkuma, të tjera nga ato të përmendura në 10 03 15
- 10 03 17* Mbetje nga prodhimi i anodave që përmbajnë zift
- 10 03 18 Mbetje nga prodhimi i anodave që përmbajnë karbon, të tjera nga ato të përmendura në 10 03 17
- 10 03 19* Pluhur nga oxhakët e gazeve që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 10 03 20 Pluhur nga oxhakët e gazeve të tjera nga ato të përmendura në 10 03 19
- 10 03 21* Mbetje të tjera të imëta dhe pluhur (përfshirë pluhurin e guzhinetave të mullirit) që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 10 03 22 Mbetje të tjera të imëta dhe pluhur (përfshirë pluhurin e guzhinetave të mullirit) të tjera nga ato të përmendura në 10 03 21
- 10 03 23* Mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 10 03 24 Mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve, të tjera nga ato të përmendura në 10 03 23
- 10 03 25* Llumra dhe shtresa filtri nga trajtimet e gazeve që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 10 03 26 Llumra dhe shtresa filtri nga trajtimet e gazeve, të tjera nga ato të përmendura në 10 03 25
- 10 03 27* Mbetje nga trajtimet e ujërave ftohës që përmbajnë vajra
- 10 03 28 Mbetje nga trajtimet e ujërave ftohës të tjera nga ato të përmendura në 10 03 27
- 10 03 29* Mbetje nga trajtimet e zgjyrave të kripës dhe zgjyrave të zeza që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 10 03 30 Mbetje nga trajtimet e zgjyrave të kripës dhe zgjyrave të zeza të tjera nga ato të përmendura në 10 03 29
- 10 03 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 10 04 Mbetje nga metalurgjia termike e plumbit
- 10 04 01* Zgjyra nga prodhimi primar dhe dytësor
- 10 04 02* Shkuma nga prodhimi primar dhe dytësor
- 10 04 03* Arsenat kalciumi
- 10 04 04* Pluhur nga oxhakët e gazeve
- 10 04 05* Mbetje të tjera të imëta dhe pluhur
- 10 04 06* Mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve
- 10 04 07* Llumra dhe shtresa filtri nga trajtimet e gazeve
- 10 04 09* Mbetje nga trajtimet e ujërave ftohës që përmbajnë naftë
- 10 04 10 Mbetje nga trajtimet e ujërave ftohës, të tjera nga ato të përmendura në 10 04 09
- 10 04 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 10 05 Mbetje nga metalurgjia termike e zinkut
- 10 05 01 Zgjyra nga prodhimi primar dhe dytësor
- 10 05 03* Pluhur nga oxhakët e gazeve
- 10 05 04 Mbetje të tjera të imëta dhe pluhur
- 10 05 05* Mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve
- 10 05 06* Llumra dhe shtresa filtri nga trajtimet e gazeve
- 10 05 08* Mbetje nga trajtimet e ujërave ftohës, që përmbajnë naftë
- 10 05 09 Mbetje nga trajtimet e ujërave ftohës, të tjera nga ato të përmendura në 10 05 08

- 10 05 10* Zgjyra dhe shkuma që janë të djegshme ose emetojnë në rast kontakti me ujin gaze të djegshme në sasi të rrezikshme
- 10 05 11 Zgjyra dhe shkuma, të tjera nga ato të përmendura në 10 05 10
- 10 05 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 10 06 Mbetje nga metalurgjia termike e bakrit
- 10 06 01 Zgjyra nga prodhimi primar dhe dytësor
- 10 06 02 Zgjyra dhe shkuma nga prodhimi primar dhe dytësor
- 10 06 03* Pluhur nga oxhakët e gazit
- 10 06 04 Mbetje të tjera të imëta dhe pluhur
- 10 06 06* Mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve
- 10 06 07* Llumra dhe shtresa filtri nga trajtimet e gazeve
- 10 06 09* Mbetje nga trajtimet e ujërave ftohës, që përmbajnë vajra
- 10 06 10 Mbetje nga trajtimet e ujërave ftohës, të tjera nga ato të përmendura në 10 06 09
- 10 06 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 10 07 Mbetje nga metalurgjia termike e argjendit, e arit dhe e platinit
- 10 07 01 Zgjyra nga prodhimi primar dhe dytësor
- 10 07 02 Zgjyra dhe ajka nga prodhimi primar dhe dytësor
- 10 07 03 Mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve
- 10 07 04 Zbutje të tjera të imëta dhe pluhur
- 10 07 05 Llumra dhe shtresa filtri nga trajtimet e gazeve
- 10 07 07* Mbetje nga trajtimet e ujërave ftohës, që përmbajnë naftë
- 10 07 08 Mbetje nga trajtimet e ujërave ftohës, të tjera nga ato të përmendura në 10 07 07
- 10 07 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 10 08 Mbetje nga metalurgjitë e tjera termike joferrore
- 10 08 04 Mbetje të tjera të imëta dhe pluhur
- 10 08 08* Zgjyrë kripë nga prodhimi primar dhe dytësor
- 10 08 09 Zgjyra të tjera
- 10 08 10* Zgjyra dhe shkuma që janë të djegshme ose emetojnë në rast kontakti me ujin gaze të djegshme në sasi të rrezikshme
- 10 08 11 Zgjyra dhe shkuma, të tjera nga ato të përmendura në 10 08 10
- 10 08 12* Mbetje nga prodhimi i anodave që përmbajnë zift
- 10 08 13 Mbetje nga prodhimi i anodave që përmbajnë karbon, të tjera nga ato të përmendura në 10 08 12
- 10 08 14 Skrape të anodave
- 10 08 15* Pluhur nga oxhakët e gazit që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 10 08 16 Pluhur nga oxhakët e gazit, të tjera nga ato të përmendura në 10 08 15
- 10 08 17* Llumra dhe shtresa filtri nga trajtimet e gazeve të oxhaqeve që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 10 08 18 Llumra dhe shtresa filtri nga trajtimet e gazeve të oxhaqeve, të tjera nga ato të përmendura në 10 08 17
- 10 08 19* Mbetje nga trajtimet e ujërave ftohës, që përmbajnë vajra
- 10 08 20 Mbetje nga trajtimet e ujërave ftohës, të tjera nga ato të përmendura e 10 08 19
- 10 08 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 10 09 Mbetje nga derdhjet e pjesëve të hekurit
- 10 09 03 Zgjyrë furnalte
- 10 09 05* Bërthamat dhe kallëpet e derdhjeve të cilat nuk i janë nënshtruar derdhjeve dhe me përmbajtje substancash të rrezikshme

- 10 09 06 Bërthamat dhe kallëpet e derdhjeve të cilat nuk i janë nënshtruar derdhjeve, të tjera nga ato të përmendura në 10 09 05
- 10 09 07* Bërthamat dhe kallëpet e derdhjeve të cilat i janë nënshtruar derdhjeve dhe me përmbajtje substancash të rrezikshme
- 10 09 08 Bërthamat dhe kallëpet e derdhjeve të cilat i janë nënshtruar derdhjeve, të tjera nga ato të përmendura në 10 09 07
- 10 09 09* Pluhur nga oxhakët e gazit që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 10 09 10 Pluhur nga oxhakët e gazit, të tjera nga ato të përmendura në 10 09 09
- 10 09 11* Mbetje të tjera të imëta që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 10 09 12 Mbetje të tjera të imëta të tjera nga ato të përmendura në 10 09 11
- 10 09 13* Mbetje të lidhjeve që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 10 09 14 Mbetje të lidhjeve, të tjera nga ato të përmendura në 10 09 13
- 10 09 15* Mbetje të agjentëve tregues që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 10 09 16 Mbetje të agjentëve tregues, të tjera nga ato të përmendura në 10 09 15
- 10 09 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 10 10 Mbetje nga derdhjet e pjesëve joferrore
- 10 10 03 Zgjyrë furnalthe
- 10 10 05* Bërthamat dhe kallëpet e derdhjeve të cilat nuk i janë nënshtruar derdhjeve dhe me përmbajtje substancash të rrezikshme
- 10 10 06 Bërthamat dhe kallëpet e derdhjeve të cilat nuk i janë nënshtruar derdhjeve, të tjera nga ato të përmendura në 10 10 05
- 10 10 07* Bërthamat dhe kallëpet e derdhjeve të cilat i janë nënshtruar derdhjeve dhe me përmbajtje substancash të rrezikshme
- 10 10 08 Bërthamat dhe kallëpet e derdhjeve të cilat i janë nënshtruar derdhjeve, të tjera nga ato të përmendura në 10 10 07
- 10 10 09* Pluhur nga oxhakët e gazit që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 10 10 10 Pluhur nga oxhakët e gazit, të tjera nga ato të përmendura në 10 10 09
- 10 10 11* Mbetje të tjera të imëta që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 10 10 12 Mbetje të tjera të imëta të tjera nga ato të përmendura në 10 10 11
- 10 10 13* Mbetje të lidhjeve që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 10 10 14 Mbetje të lidhjeve, të tjera nga ato të përmendura në 10 10 13
- 10 10 15* Mbetje të agjentëve tregues që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 10 10 16 Mbetje të agjentëve tregues, të tjera nga ato të përmendura në 10 10 15
- 10 10 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 10 11 Mbetje nga prodhimi i qelqit dhe produkteve të qelqit
- 10 11 03 Mbetje të materialeve me fibra qelqi
- 10 11 05 Pjesë të imëta dhe pluhura
- 10 11 09* Mbetje të përzierjeve të përgatitura përpara përpunimit termik, që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 10 11 10 Mbetje të përzierjeve të përgatitura përpara përpunimit termik, të tjera nga ato të përmendura në 10 11 09
- 10 11 11* Mbetje qelqi në pjesë të imëta dhe pudër qelqi që përmbajnë metale të rënda (nga tubat e rrezeve katodike)
- 10 11 12 Mbetje qelqi, të tjera nga ato të përmendura në 10 11 11
- 10 11 13* Llumra të lustrimit dhe bluarjes(grimcimit) të qelqit, që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 10 11 14 Llumra të lustrimit dhe bluarjes(grimcimit) të qelqit, të tjera nga ato të përmendura në 10 11 13
- 10 11 13* Llumra të lustrimit dhe bluarjes(grimcimit) të qelqit, që përmbajnë substanca të rrezikshme

- 10 11 16 Mbetje të ngurta nga trajtimet e gazit të oxhaqeve, të tjera nga ato të përmendura në 10 11 15
- 10 11 17* Llumra dhe shtresa filtri nga trajtimet e gazeve të oxhaqeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 10 11 18 Llumra dhe shtresa filtri nga trajtimet e gazeve të oxhaqeve, të tjera nga ato të përmendura në 10 11 17
- 10 11 19* Mbetje të ngurta nga trajtimi në vend i derdhjeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 10 11 20 Mbetje të ngurta nga trajtimi në vend i derdhjeve, të tjera nga ato të përmendura në 10 11 19
- 10 11 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 10 12 Mbetje nga prodhimi i qeramikeve, tullave, tjegullave, pllakave dhe prodhimeve të ndërtimit
- 10 12 01 Mbetje nga përzierjet e përgatitura përpara përpunimit termik
- 10 12 03 Pjesë të imëta dhe pluhura
- 10 12 05 Llumra dhe shtresa filtri nga trajtimet e gazeve
- 10 12 06 Kallëpe skarco
- 10 12 08 Mbetje qeramike, të tullave, tjegullave, pllakave dhe produkteve të ndërtimit (pas përpunimit termik)
- 10 12 09* Mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 10 12 10 Mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve të tjera nga ato të përmendura në 10 12 09
- 10 12 11* Mbetje nga emalimi dhe smaltimi, që përmbajnë metale të rënda
- 10 12 12 Mbetje nga emalimi dhe smaltimi, të tjera nga ato të përmendura në 10 12 11
- 10 12 13 Llumra nga trajtimi i derdhjeve
- 10 12 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 10 13 Mbetje nga prodhimi i çimentos, gëlqeres, allçisë dhe prodhimeve të përfutuara prej tyre
- 10 13 01 Mbetje nga përzierjet e përgatitura përpara përpunimit termik
